

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Matura 2021

**UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E PËRGJIGJEVE TË NXËNËSVE
SESIONI I**

LËNDA: SOCIOLOGJI- FILOZOFI
Gjinnazi

Varianti B

Udhëzime të Përgjithshme

Në testin e sociologjisë dhe filozofisë përdoren dy lloje pyetjesh, të cilat vlerësojnë kompetencat të nxënësve për secilin nxënës. Një nga llojet është pyetja me alternativa, ku nxënësit do të zgjedhin atë alternativë që i përgjigjet pyetjes. Çdo pyetje e këtij lloji ka një përgjigje të vetme të saktë. Përgjigjet e pyetjeve me alternativa do të vlerësohen në mënyrë elektronike.

Lloji tjetër i pyetjeve është ai me shtjellim, ku nxënësi e shkruan përgjigjen në hapësirën e përcaktuar në test. Këto pyetje vlerësohen nga vlerësuesi, të cilët do të përdorin udhëzimet e pikëzimit të përshkruara në vijim të këtij manuali.

Qëllimi i këtij materiali është të sigurojë për vlerësuesit informacionin dhe udhëzimet për shpërndarjen e pikëve, të nevojshme për të caktuar në mënyrë të besueshme dhe të vlefshme vlerësimin e përgjigjeve të secilit nxënës.

Secila prej pyetjeve me shtjellim ka një vlerë pikësh prej 1 (një), 2 (dy) ose 3 (tre) pikë, në varësi të thellësisë së të kuptuarit ose shkallës së mbështetjes së argumentit që kërkon pyetja.

Udhëzuesi i pikëzimit përshkruan aspekte të veçanta të përgjigjes për çdo pyetje. Secila pyetje e testit ka udhëzuesin e vet, të përshtatur për elemente specifike të saj. Megjithatë ekzistojnë disa pika të përbashkëta tek të gjithë udhëzuesit. Për shembull, niveli më i ulët i pikëve, në secilin udhëzues, është 0 pikë. Në këtë rast përgjigjja e dhënë dëshmon se nxënësi nuk ka kuptuar një aspekt të caktuar të pyetjes. Përgjigjet që marrin një vlerësim me 0 pikë, mund tregojnë se pyetja është kuptuar keq, ose ato përfshijnë informacione aq të paqarta, sa vendosja e një pike më të lartë nuk mund të justifikohet.

Në test ka pyetje ku nxënësit do të përgjigjen në mënyra të ndryshme. Prandaj, do të ishte e papërshtatshme që të vendoset në udhëzues një përgjigje specifike, unike, që pritet të japin në test të gjithë nxënësit. Është përgjegjësia e vlerësuesit dhe më pas e komisionit të vlerësimit, që të marrë parasysh përgjigjen që nxënësi ka dhënë, dhe ta vlerësojë atë si të plotë, të pjesshme apo të pasaktë.

Në testin e sociologjisë dhe filozofisë idetë e dhëna nga nxënësit dhe larmia e interpretimeve që ata sjellin për secilën pyetje, çon në shumë përgjigje të paparashikueshme. Udhëzuesi i pikëzimit dhe shembujt e dhënë në të duhet të jenë gjithmonë baza për secilin vendim që komisioni i vlerësimit do të japë. Megjithatë ne i inkurajojmë vlerësuesit që t'i lexojnë përgjigjet e nxënësve në mënyrë mbështetëse, domethënë që mund të lejojnë gabime të vogla ose mungesë qartësie, është e domosdoshme që vlerësuesit të mos interpretojnë mbi përgjigjet e dhëna nga nxënësit. Ata nuk duhet të supozojnë se çfarë donte të thoshte nxënësi në përgjigjen e tij. Vlerësuesit duhet ta vlerësojnë secilën përgjigje të nxënësit sipas përgjigjes konkrete që ka dhënë ai. Në fund të fundit, kjo është mënyra më e drejtë, e besueshme dhe e vlefshme për pikëzimin e përgjigjeve të nxënësve për këto lloje pyetjesh.

Sociologji

SOCIOLOGJI-FILOZOFI

Sociologji-Filozofi- Sesioni I

Varianti B

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetje 4	C	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 9	A	1 pikë
Pyetja 14	A	1 pikë
Pyetja 15	C	1 pikë
Pyetja 17	D	1 pikë
Pyetja 19	A	1 pikë
Pyetja 20	B	1 pikë

Pyetja 3
Model përgjigjeje 1 pikë

- Përgjatë periudhës së pushtimit të Shqipërisë nga Perandoria Osmane, kultura shqiptare është zhvilluar si kundërkulturë. Kultura shqiptare binte ndesh në norma, vlera me kulturën e diktuar nga pushtuesi.
- Në periudhën e Rilindjes Kombëtare u zhvilluan elementë të kulturës shqiptare, duke kundërshtuar kulturën e pushtuesit. Këta elementë u zhvilluan nga mërgimtarët, të cilët frymëzuan lëvizjet kombëtare për çlirim.
- Në periudhën e regjimit monist shumë vepra letrare dhe të artit kanë zhvilluar elementë kundërkulturorë.
- Lëvizja Demokratike e Studentëve të dhjetorit në 1990 u zhvillua si kundërkulturë përballë vlerave e normave kulturore sunduese të kohës moniste. Këto lëvizje i hapën rrugën zhvillimeve të shoqërisë shqiptare.

1 pikë nëse jep një nga argumentat e sipërpërmendura;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 5
Model përgjigjeje 2 pikë

Normat ligjore janë të bazuara në normat kulturore të një shoqërie. Normat kulturore që kanë një rëndësi të madhe në ruajtjen e kohezionit shoqëror e moral dhe konsiderohen të domosdoshme për funksionimin e shoqërisë sociologu Samner i quan more. Shoqëria ka reagime të ashpra kur ato shkelen, ndaj për shkak të rëndësisë janë sanksionuar edhe si norma ligjore.

2 pikë nëse shpjegon lidhjen e konceptit more nga Samner me normat ligjore dhe kulturore;
OSE

1 pikë nëse shpjegon konceptin more nga Samner OSE nëse shpjegon lidhjen mes normave ligjore me normat shoqërore;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 7
Model përgjigjeje 1 pikë

Sipas sociologut Ç. H Kuli njerëzit kanë aftësinë:

- të kuptojnë qëllimet e të tjerëve dhe mënyrën e reagimeve duke vendosur veten në rolin e tjetrit.
- përmes përdorimit të simboleve në ndërveprimin shoqëror, njerëzit përfytyrojnë veten sipas asaj që të tjerët i shohin dhe reagojnë ndaj tyre.
- të përcaktojnë rolin e tjetrit si pasqyrë në të cilën shohin veten.

1 pikë nëse përcakton një nga alternativat e mësipërme.

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 8

2 pikë

Model përgjigjeje

- Në mungesë të organeve shtetërore, gjakmarrja në shoqërinë tradicionale shqiptare konsiderohej e drejtë që bazohej në Kanun.
- Me krijimin e shtetit me organet përkatëse, gjakmarrja ndëshkohet, sepse bie ndesh me normat ligjore, për këtë trajtohet si sjellje deviante.

2 pikë nëse analizon dy alternativat e mësipërme

1 pikë nëse analizon një nga alternativat e mësipërme

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10

3 pikë

Model përgjigjeje

Disa nga drejtimet kryesore të pabarazise gjinore:

- **Pabarazi ndërgjinore në punësim dhe të ardhura** – në shoqëritë e sotme është rritur numri i punësimit ndër gratë, megjithatë ato angazhohen në profile pune më pak fitimprurëse. Ende vihet re “tavani i qelqtë” që pengon përparimin e tyre në poste drejtuese.
- **Punët e shtëpisë “turni i dytë” i grave** – Punët e shtëpisë dhe rritja e edukimi i fëmijëve konsiderohen si “detyrë” e grave. Një angazhim i tillë është impenjues e megjithatë ato janë të punësuar jashtë ekonomisë familjare vijojnë të mbajnë këtë peshë. Këto funksione të gruas brenda dhe jashtë shtëpisë e pengojnë përparimin e saj në karrierën profesionale, politike, shoqërore.
- **Shpërpjesëtime ndërmjet arsimimit dhe punësimit** – Në ditët e sotme numri i vajzave që arsimohen është shumë i lartë, madje kanë rezultate më të larta se djemtë, megjithatë vihet re se përparimi në karrierë dhe paga është më e lartë te burrat. Profilet më të larta në karrierë dominohen nga burrat. Këto janë profesione të mirëkualifikuara të cilat janë të mirëpaguara dhe kanë prestigj në shoqëri.

3 pikë nëse identifikon tre nga drejtimet e mësipërme;

2 pikë nëse identifikon dy nga drejtimet e mësipërme;

OSE

1 pikë nëse identifikon një nga drejtimet e mësipërme të pabarazisë gjinore;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetje 11

2 pikë

Model përgjigjeje

- Historia ka treguar se në disa raste pakicat etnike janë persekutuar nga shumica, për shembull, shfarosja e hebrenjve, romëve etj, nga regjimi nazist.
- Forma më e skajshme e etnocentrizmit është genocidi ose njohur ndryshe si shfarosja. Kjo dukuri shoqërore lidhet me zhdukjen e një grupi njerëzish nga një tjetër grup duke përdorur dhunën.

2 pikë nëse shpjegon marrëdhëniet mes shumicës dhe pakicave etnike bazuar te genocide/shfarosja;

OSE

1 pikë nëse shpjegon vetëm marrëdhëniet mes shumicës dhe pakicave etnike OSE nëse shpjegon vetëm genocidin/shfarosjen.

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12

2 pikë

Model përgjigjeje:

Sipas kuptimi sociologjik të fesë, nga sociologu i shquar Dyrkheim, të gjitha fetë:

- iu referohen besimit të fuqitë e mbinatyrshe;
- i tejkalojnë kufijtë e dijeve tona ose ndryshe, janë dallimi mes profanes dhe të shenjtës, ku profania i referohet të gjitha elementeve të zakonshme të jetës së përditshme, ndërsa e shenjta i referohet të jashtëzakonshmes;

- janë çështje besimi që nuk kanë nevojë të mbështeten në prova shkencore;
- varen nga perceptimi i individit, nga mënyra si e ndjen, nga kultura dhe mënyra si është edukuar;
- përfshijnë sisteme simbolesh, që iu referohen ndjenjave të nderimit, të adhurimit e të frikës;
- përfshijnë rituale dhe ceremoni të kryera nga bashkësitë e besimtarëve.

2 pikë nëse dallon dy nga tiparet e mësipërme të fesë;

OSE

1 pikë nëse dallon një nga tiparet e mësipërme të fesë;

0 pikë nëse dallon gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13

1 pikë

Model përgjigjeje

Në regjimin monist prirjet shekullarizuese u nxitën si bashkërendim i faktorëve:

- masivizimi i arsimit, rritja e nivelit arsimor në masat e përgjithshme të popullsisë.
- masat e marra nga regjimi për të ndaluar zyrtarisht ushtrimin e besimeve fetare dhe praktikave fetare.

1 pikë nëse përcaktohet një nga faktorët e mësipërm.

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16

2 pikë

Model përgjigjeje

- Vihet re një pakësimi i punës së gjallë të njerëzve në bujqësi. Prodhimtaria në sektorin e bujqësisë në vendet më të zhvilluar është rritur, ndikuar nga zbatimi të dijeve shkencore, përdorimi i pajisjeve teknike. Në rastin e Shqipërisë vitet '90 u shoqëruan me mbylljen e shumë ndërmarrjeve, si rrjedhojë u rrit numri i të punësuarve në bujqësi. Pas viteve 2000 ky tregues shfaq rënie. Në të ardhmen pritet që situata të ndryshojë me përdorimin e pajisjeve teknike të përparuara.
- Ka rritje të peshës së punëve "jakëbardhë" (cilësohen ato punë që kërkojnë profesionalizëm mendor, organizues, drejtues). Në vendet e industrializuara që pas Luftës së Dytë Botërore është rritur shumë numri i punonjësve "jakëbardhë". Në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore e veçanërisht gjatë viteve '90 deri në ditët tona është rritur gradualisht numri i të punësuarve në profesione "jakëbardhë".
- Shtimi i profesioneve, të cilat kanë këto karakteristika:
 - Së pari është zotërimi i njohurive teknike. Specialistët e punëve profesionale arsimohen dhe kualifikohen në shkollë të lartë e studime pas universitare. Rol luajnë edhe vetëkualifikimet.
 - Së dyti specialistët "jakëbardhë" kanë pavarësi në veprimtarinë profesionale.
 - Së treti specialistët kanë dije dhe përvojë të dobishme ndaj nderohen për shembull: mjekët, avokatët etj.
 - Së katërti në veprimtarinë profesionale të specialistëve interesat e bashkësisë kanë më shumë peshë se interesat vetjak, ndaj kanë prestigj të lartë në shoqëri. Veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore në shoqëritë industriale të zhvilluara është rritur numri i specialistëve me arsim të lartë dhe shumë profile. Në Shqipëri ka prirje të njëjtë për shtimin e specialistëve, por ndryshon sigurojnë të ardhura të pakta. Kjo konsiderohet si një gjendje kalimtare.
- Pakësim të numrit të të vetëpunësuarve në vendet më të industrializuara. Në rastin e Shqipërisë pas kolektivizimit të bujqësisë deri në vitin 1990 nuk kishte të vetëpunësuar. Me kalimin në ekonominë e tregut të lirë u krijuan njësi të ekonomisë private. Statistikat e viti 2016 tregojnë se përafërisht 56% e personave të aftë për punë ishin të vetëpunësuar. Prirja do të jetë që numri i të vetëpunësuarve të ulet me krijimin e njësive ekonomike të mëdha.
- Papunësia në vendet e zhvilluara industriale lidhet me ndërprerjen e prodhimit në një degë, daljen nga qarkullimi të profesioneve, lidhet me faktor moshor, nivel arsimor, përkatësi gjinore, etnike. Vendet e zhvilluara industriale kanë norma të larta papunësie ndër të rinjtë 16-19 vjeç të pakualifikuar dhe kjo normë ulet tek të mirëarsimuarit. Në Shqipëri në regjimin monist nuk kishte të papunë të deklaruar zyrtarisht. Me rënien e regjimit monist dhe futjen në ekonominë e tregut numri i të papunëve u rrit ndjeshëm. Statistikat e papunësisë mund të jenë më të ulta për arsye të informalitetit.
- Ekonomia e paligjshme në vendet e zhvilluara industriale shfaqet në nivele të ulta. Shqipëria si demokraci në tranzicion, përlllogaritet të ketë ekonomi të paligjshme në nivele të larta. Ndër arsyet për këtë situatë përmendim: prirja e disa njerëzve për t'u pasuruar shpejtë, mungesa e eksperiencës së organeve shtetërore për të kontrolluar veprimtarinë ekonomike etj.
- Rritja e shkallës së bashkëpunimit të punonjësve të etnive, racave, të ndryshme vihet re në vendet e zhvilluara industriale, por edhe në radhët e specialistëve në Shqipëri. Kjo ndodh jo vetëm në kompanitë shumëkombëshe, por edhe në nivele më të ngushta të bashkëpunimit me specialist të vendeve të ndryshme.

- Përdorimi i teknologjisë së informacionit ka ndryshuar veprimtarinë e njerëzve sepse po realizojnë procese pune të komplikuar dhe një tjetër vecori është se me përdorimin e kompjuterave nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë me vendin e punës. Ky tipar i punës vihet re edhe në Shqipëri.

2 pikë nëse krahason një nga aspektet e mësipërme;
OSE

1 pikë nëse shpjegon një veçori të punës në vendet më të industrializuara **OSE** në Shqipëri.

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18

2 pikë

Model përgjigjeje

- Familja ku lind individi përcakton veprimtarinë profesionale të tij. Ata vendosin për profesionin që fëmija do të marrë në të ardhmen;
- Pozita shoqërore e individit trashëgohet brez pas brezi. Martesa shërben si element për këtë qëllim, ku individët martohen me anëtarë brenda të njëjtës kastë;
- Sistemi i kastës përforcohet dhe përkrahet nga elementë të kulturës dhe besimeve fetare. Kastat cilësohen si vullnet hyjnor i paracaktuar dhe i pa dhunueshëm.

2 pikë nëse shpjegon dy nga cilësitë e mësipërme;

1 pikë nëse shpjegon një nga cilësitë e mësipërme.

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21

2 pikë

Model përgjigjeje

Metoda e vëzhgimit.

- Vëzhgimi është një metodë e mirë për studimin e grupimeve të vogla;
- Vëzhgimi i pjesshëm sepse shtrihet vetëm në një nga hapësirat (dyqanet e veshjeve) ku shfaqet dukuria (respektimi i masave anti-covid);
- Vëzhgim josisematik (i drejtpërdrejtë, jo i drejtpërdrejtë); pasi realizohet në periudha kohore të caktuara, për të studiuar dukurinë (respektimi i masave anti-covid);
- Vëzhgim i drejtpërdrejtë (jopjesëmarrës).

2 pikë nëse vlerëson metodën dhe argumenton pse;

OSE

1 pikë nëse vlerëson metodën pa e argumentuar përgjigjen;

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Filozofi

Pyetja 22	D	1 pikë
Pyetja 23	D	1 pikë
Pyetja 24	A	1 pikë
Pyetja 27	B	1 pikë
Pyetja 29	B	1 pikë
Pyetja 30	D	1 pikë
Pyetja 34	C	1 pikë
Pyetja 36	B	1 pikë
Pyetja 37	D	1 pikë
Pyetja 38	A	1 pikë

Pyetja 25 2 pikë
Model përgjigjeje

Platoni e ndau realitetin në dy pjesë:

-Bota e sendeve, ajo është në ndryshim të vazhdueshëm pasi përbëhet nga lënda dhe nuk është e përjetshme.

-Bota e ideve (formave) në të cilën gjenden format e pandryshueshme të gjithçkaje që shohim, është e përjetshme dhe arrihet përmes arsyes.

2 pikë nëse përcakton botën e sendeve dhe ideve;

OSE

1 pikë nëse përcakton saktë një nga pjesët e realitetit.

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 26 2 pikë
Model përgjigjeje

- Për stoikët gjithçka është e paracaktuar nga arsyeja hyjnore. Ajo që ndodh është e pashmangshme.
- Njeriu duhet t'i nënshtrohet fatit të tij, të përballoj me qetësi çdo të mirë dhe të keqe.

2 pikë nëse shpjegon dy elementët e mësipërm;

OSE

1 pikë nëse shpjegon vetëm një nga elementët e mësipërm.

0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 28 3 pikë

Model përgjigjeje

a) *Zoti është burimi i gjithçkaje.* Plotini e shpjegon zanafillën e botës nga Njëshi, duke e krahasuar me dritën që buron nga dielli. Dielli asnjëherë nuk shuhet, ai i jep dritë dhe ngrohtësi gjithçkaje. Po kështu, Zoti i jep formë dhe jetë realitetit. Ai është krijuesi ose burimi i gjithçkaje.

b) *Zoti është vetë përsosmëria.* Sikurse energjia që buron nga Dielli, Njëshi ndriçon çdo gjë, por drita e tij vjen duke u zbehur sa më larg të jenë krijesat etij. Qeniet që rrjedhin nga Zoti, kanë rënie graduale në shkallën e tyre të përsosmërisë, pra nga Njëshi që është përsosmëria absolute, te njeriu, kafshët, bimët dhe në fund materia lëndore. Pra, Njëshi është përcaktuesi i vetive dhe i shkallës së përsosmërisë.

c) Njëshi ose Zoti është *i pavdekshëm dhe i përhershëm*, sepse ka ekzistuar para gjithçkaje dhe gjithmonë. Ai është vendi ku shpirti i njeriut kthehet përsëri. Për këtë qëllim duhet që njeriu të përsosë vetitë morale ose virtytet.

d) Njëshi është *uniteti absolut*, një dhe i vetëm, është pjesa më e lartë e intelektit. Bota materiale është pasqyrim i botës së intelektit. Ajo reflekton në mënyrë pasive realitetin.

e) Ai është krijuesi i të mirës dhe virtytit. Zoti nuk është shkaku i ekzistencës së të keqes në botë. E keqja është mungesa e dritës dhe ngrohtësisë së Njëshit në zemrat e njerëzve.

- 3 pikë** nëse identifikon tre funksione të Njështit;
OSE
2 pikë nëse identifikon dy funksione të Njështit;
OSE
1 pikë nëse identifikon një funksion të Njështit;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31 **1 pikë**
Model përgjigjeje

- Akuini mendonte se besimi dhe arsyeja nuk janë në kontradiktë me njëra-tjetrën sepse burojnë nga Zoti.
- Për të provuar ekzistencën e Zotit jepen prova përmes arsyes (5 provat).

1 pikë nëse jep një nga përgjigjet e mësipërme.
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32 **2 pikë**
Model përgjigjeje

- Në qytetin e Zotit njerëzit i besojnë, e duan dhe i përkushtohen Zotit. Ai është qyteti ku ka drejtësi dhe lumturi. Në qytetin e Zotit janë njerëzit besimtarë.
- Në qytetin tokësor njerëzit jepen pas kënaqësive trupore dhe kërkojnë lumturinë në gjërat materiale.

2 pikë nëse shpjegon qytetin e Zotit dhe qytetin tokësor;
OSE
1 pikë nëse shpjegon vetëm qytetin e Zotit **OSE** vetëm qytetin tokësor.
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33 **1 pikë**
Model përgjigjeje

Njeriu krijon ide pas perceptimit me shqisat, ai lind pa ide, pra tabula rasa. Njohja fillon dhe kufizohet tek përvojat shqisore. Loku si empirist pranon se njohja vjen përmes eksperiencës.

1 pikë nëse argumenton perceptimin lidhur me njohjen empirike.
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 35 **2 pikë**
Model përgjigjeje

Dy aspekte të teorisë së Spinozës mbi Zotin:

- Zoti është shkaku i të gjitha gjërave – asgjë nuk mund të ekzistojë apo të konceptohet pa Zotin. Meqënëse çdo gjë buron prej tij, në natyrë ekziston determinizmi, pra asgjë nuk është rastësore. Shkaqet dhe pasojat ndërthurren në mënyrë të domosdoshme. Çdo gjë e gjen shpjegimin te Zoti. Edhe njeriu është pjesë e natyrës i nënshtrohet këtij rregulli. Njeriu e beson veten të lirë, por kjo arrihet kur ai njuh të njohë vendin e tij në Natyrë, pra të pranojë fuqinë e Zotit. Nëse mendojmë se është vullneti që na drejton, mund të biem pre e iluzioneve dhe gabimeve.
- Zoti është thelbi i gjithçkaje që ekziston – Zoti është substanca nga e cila përbëhet gjithçka që ekziston. Ai ndodhet edhe brenda njeriut, si pjesë e natyrës. Zoti është baraz me natyrën. Ky konsiderohet si njëllaj panteizmi. Por, për shkak të kufijve të intelektit njerëzor, ne arrijmë të njohim vetëm dy attribute: vetinë e shtrirjes, që është bota materiale dhe vetinë e mendimit që është bota mendore. Zoti është substanca që qëndron në themel të realitetit dhe çdo gjë që ekziston, është mënyrë e shprehjes së tij.

2 pikë nëse shpjegon dy aspekte të filozofisë së Zotit te Spinoza;
OSE
1 pikë nëse shpjegon një aspekt të filozofisë së Zotit te Spinoza;
0 pikë nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 39

2 pikë

Model përgjigjeje

- Imperativi kategorik lidhet me tërësinë e urdhëresave morale të diktuar nga arsyeja. Ato kanë formën universale dhe vlejné si detyrim për të gjitha situatat. Lidhet me detyrën si urdhëresë e brendshme e arsyes dhe ndërgjegjes.
- Imperativi hipotetik është i vlefshëm për disa situata dhe nuk ka trajtë universale. Nënkupton kërkesa të kushtëzuara në formën "nëse dëshiron A duhet të bësh B". Realizimi i një dëshire përfshin realizimin e një veprimi, plotësimin e një kushti të caktuar rrethanor.

2 pikë nëse krahason imperativin kategorik me imperativin hipotetik

OSE

1 pikë nëse jep një shpjegim të imperativit kategorik OSE hipotetik

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare

Pyetja 40

2 pikë

Model përgjigjeje

- Nuk ka një zgjedhje të vetme të drejtë mes dy alternativave;
- Njeriu si qenie e lirë subjektive është kriteri i zgjedhjeve të tij;
- Njeriu duke qenë i lirë zgjedh një nga alternativat bashkë me përgjegjësitë që shoqërojnë këtë zgjedhje;
- Njeriu do zgjedhë njërin nga alternativat duke i dhënë kuptim të ardhmes së tij përmes kësaj zgjedhje;
- Njeriu projektton të ardhmen në liri të plotë;
- Në zgjedhjet e tij, njeriu shfaq jo vetëm një përgjegjësi individuale por edhe kolektive;

2 pikë nëse argumenton përgjigjen përmes dy aspekteve të mësipërme;

OSE

1 pikë nëse argumenton përgjigjen përmes një aspekti të mësipërm.

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 41

3 pikë

Model përgjigjeje

a) Misioni i filozofisë, sipas Marksit, është të ndryshojë botën. Ajo nuk është thjesht një vepër teorike, por i shërben veprimit.

Sipas tij, teoria është në unitet me praktikën dhe duhet t'i shërbejë asaj. Filozofia e Marksit ka funksion praktik. Veçori e filozofisë marksiste është angazhimi në praktikën politike, si qëllimi përfundimtar. Filozofia e Marksit kryen dy funksione: njeh realitetin dhe përpiqet ta ndryshojë atë, përmes veprimit revolucionar.

b) Rruga e ndryshimit shoqëror, sipas Marksit historia ecën përpara përmes zgjidhjes së kontradiktave, nga një rend më i ulët ekonomik-shoqëror, në rend të ri më të përparuar. Marksi besonte në një sistem shoqëror më të mirë sesa kapitalizmi, që do arrihej me përmbyesje revolucionare, sepse çdo shtet në themel është dhunë e njëres klasë ndaj tjetrës. Sipas tij, kapitalizmi do të zëvendësohej nga rendi komunist, i cili do të vinte përmes revolucionit me dhunë të proletariatit të shfrytëzuar, që kishte në dorë të ardhmen e shoqërisë.

c) klasa që do të sillte këtë ndryshim ishte ajo e proletarëve. Ky grupim nuk zotëronte asgjë përveç fuqisë punëtore dhe shfrytëzohej nga kapitalistët.

3 pikë nëse vlerëson dy momente të rolit të filozofisë DHE klasën që do të sillte ndryshimin;

OSE

2 pikë nëse vlerëson dy momente të rolit të filozofisë OSE një moment të rolit të filozofisë dhe klasën që do të sillte ndryshimin;

OSE

1 pikë nëse vlerëson një moment të rolit të filozofisë OSE klasën që do të sillte ndryshimin;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.